



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORATEVE PËR VITIN 2019

Lipjan, Janar 2019

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2019

-Për Lipjanin që është bazament i qeverisjes së tanishme lokale, objektivat tona strategjike për vitin 2019 janë këto:

- 1. Lipjani, një vend i qetë për të jetuar e punuar ndershëm dhe për të rritur, edukuar fëmijet dhe mbajtur familjen.**
- 2. Ofrimin e shërbimeve administrative dhe publike cilësore dhe informim publik cilësor.**
- 3. Promovimi dhe përmirësimi i ambientit të të bërit biznes në Lipjan.**
- 4. Infrastrukturë dhe ambiente të përshtatëshme mësimore për mësimëdhënie dhe mësimnxënie kualitative bashkëkohore.**
- 5. Sigurimin e buxhetit të balancuar dhe stabil në investime dhe mirëmbajtje adekuate të objekteve dhe aseteve komunale.**
- 6. Shtimin e investimeve dhe kapaciteteve për kujdesin shëndetësor primar për një popullsi të shëndoshë me shërbime efektive.**
- 7. Investim dhe mirëmbajtje të objekteve sportive dhe të ambienteve për rekreacion, për të shtuar hapsira për rini dhe aktivitete tjera sportive.**
- 8. Planifikim të qëndrueshëm ekonomik lokal dhe planifikim modern urban të qytetit me theks të veçant rregullimin e qarkullimit në trafik.**

9. Shtimi dhe mirëmbajtja e parqeve, hapësirave publike, shtigjeve të ecjes dhe bicikletave dhe mbjellja e pemëve, mirëmbajtja dhe ndërtimi i shtretëve të lumenjëve.

10. Ndërtimi i rrugëve, ndërtesave dhe infrastrukturës tjetër publike me standarde të larta në shërbim të të gjithë qytetarëve.

11. Bashkëpunim të vazhdueshëm me kompanit publike për shtimin e kapaciteteve për ujë të pijes dhe për shërbime me efikasitet në grumbullimin e mbeturinave për një ambient më të pastër.

12. Bashpunimi me komunitete fetare, shoqërit civile, OJQ dhe organizmat të tjerë për të gjetur mundësitë e kujdesit në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, lapidarëve dhe monimenteve tjera kulturore dhe fetare.

Drejtoria i Administratës

Objektivat kryesore në Drejtoratin e Administratës për vitin 2019 janë:

- Efikasiteti i punës në administratë,**
- Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe cilësore për qytetarë,**
- Administratë Digjitale,**
- Vendosja e GPS në veturat zyrtare,**
- Transparenca dhe llogaridhënja,**
- Krijimi i sistemit të integruar të menxhimit të radhës,**
- Ofrimi i shërbimeve elektronike dhe lehtësishtë të qasëshme.**
- Njoftimi me sms palët për përgjigje nga Komuna,**
- Zbatimi i kontratave në bazë të kushteve të parapara.**
- Racionalizimin e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes në Administratë.**

Drejtoria e Arsimit

Për periudhën njëvjeçare të vitit 2019 Drejtoria e Arsimit në Lipjan synon arritjen e prioriteteve si:

- Funksionalizimi i kabineteve të TIK-ut në shumicën e shkollave të Komunës,**
- Zgjerimi i kapaciteteve të çerdhes publike për pranimin e fëmijëve të moshës 1-5,**
- Sigurimi i kabineteve të shkencave të natyrës për disa shkolla fillore dhe të mesme,**
- Fuqizimi i të gjitha organeve profesionale të shkollave si këshillat e prindërve dhe këshillat drejtuese si dhe inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e arsimit dhe arsimimit të përgjithshëm,**
- Zbatimi i programeve të veçanta kundër braktisjes së shkollës,**
- Nxjerrja e rregulloreve, mbikëqyrja dhe zbatimi i tyre si dhe Informimi i Kuvendit Komunal për rezultatet, vështirësitë dhe rrjedhën e procesit edukativo-arsimor në tërësi në komunën tonë,**
- Angazhimi në sistemimin e nxënësve me nevoja të veçanta nëpër klasa të bashkangjitura si dhe sigurimi i mësuesve mbështetës për ta,**
- Ngritja e përqindjes së arritshmërisë dhe kalueshmërisë në vlerësimet e jashtme,**
- Organizimi i mësimi shtesë për lëndët prioritare si dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasat e mbingarkuara.**

Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport

- Hartimi dhe implementimi i Planit të veprimit Rinor Lokal,**
- Fuqizim dhe promovim të vullnetarizmit,**
- Ndërtimi i legjislacionit lokal për qështje të titujve të nderit, mirënjohjeve, dekoratave dhe medaljeve,**
- Riorganizimi si dhe fuqizimin e Ansambleve të këngëve dhe valleve,**
- Organizimi i Debateve, Tryezave, Ligjeratave, Konferencave, me të rinjtë,**
- Organizimi i aksioneve të ndryshme rinore për mbrojtjen e ambientit dhe fusha të tjera,**
- Mbrëmje rinore për festa Kombëtare dhe Shtetore,**
- Organizimi i kampeve verore me sportist dhe identifikimi i talentëve të rinj të sportit,**
- Organizime të programeve kulturore me rastin e festave, organizime të manifestimeve për ditët e caktuara.**

Drejtoreti për Buxhet dhe Financa

- Të sigurohet një pozitë e qëndrueshme financiare e Komunes së Lipjanit,**
- Të sigurohet një planifikim fiskal dhe financiar i shëndoshë,**
- Të zhvillohet edhe më tutje dhe të administrohet një menaxhim financiar efektiv përmes të cilit drejtoratet dhe të gjithë zyrtarët autorizues të kenë mundësinë të administrojnë buxhetet e planifikuara dhe te aprovuara,**
- Menaxhim transparent të buxhetit komunal dhe të publikohen në webfaqen e Komunes të gjitha raportet nga drejtoreti për Buxhet dhe Financa si dhe subvencionet,**
- Realizimi i të hyrave vetanake sipas planifikimit buxhetor,**
- Inkasim të tatimit në pronë duke vazhduar me qasjen zero tolerancë ndaj mospagesës së tatimit në pronë dhe qasjes të njëjtë për të gjithë,**
- Regjistrimi i të gjitha pasurive komunale dhe pasurive në vijim.**

Drejtora ti për Ekonomi dhe Zhvillim

- Intensifikimi i angazhimeve për përmisimin e klimës së të bërë biznes dhe promovimin e resurseve të Komunës së Lipjanit,**
- Hartimi i politikave dhe dokumenteve strategjike të zhvillimit ekonomik lokal,**
- Vazhdimi i angazhimeve rrethë gjetjes së burimeve të financimit për ndërtimin e Zonave Ekonomike,**
- Hartimi i dokumenteve dhe materialeve të marketingut me qëllim të tërheqjes së investitorëve të jashtëm dhe vendor si dhe tërheqjen e turistëve në destinacionet turistike të Komunës së Lipjanit,**
- Vendosja e kontakteve dhe raporteve bashkëpunuese me Donatorët dhe Ambasadat e huaja rreth angazhimit të përbashkët për rritjen e Zhvillimit Ekonomik në Lipjan,**
- Promovimi i ofertes Investive dhe promovimi i Turizmit,**
- Vendosja e Platformës Elektronike e cila do të ketë për qëllim informimin me kohë të Sektorit Privat, shoqërisë civile dhe grupet tjera të interesit rreth burimeve të financimit,**
- Rritja e zhvillimit ekonomik në Komunën e Lipjanit përmes rishikimit dhe lehtësimit të procedurave administrative me theks të veçantë procedurat e dhënjes së lejeve dhe pëlqimeve,**
- Rritja e bashkëpunimit institucional në mes të Komunës së Lipjanit dhe Sektorit Privat dhe përfshirja e Sektorit Private në vendimmarrje,**
- Publikimi, menaxhimi dhe mbajtja e evidencës për pronën komunale,**
- Fokusimi në inovacione,**

- Smart City/Përgjegjësia ndaj ambientit dhe përgjegjësia sociale (CSR),**
- Vazhdimi i menaxhimit transparent,**
- Monitorimi i implementimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik,**
- Menaxhimi i hartimit të aplikacioneve për projektet e dorëzuara te donatorët.**

Drejtoria i Inspektoriatit

- Kontrollimi dhe mbikqyrja e kushteve të sigurisë së ushqimit për konsumatorë si dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve në bazë të ligjeve në fuqi,**
- Ndalimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore,**
- Mbikqyrja e ndërtimit të objekteve me leje ndërtimore,**
- Inspektimi dhe ndërmarrja e veprimeve ligjore në fushën e mjedisit (ambientit),**
- Inspektimi dhe mbikqyrja e transportuesëve rrugor të udhëtarëve,**
- Inspektime të vazhdueshme gjatë tërë vitit të barantoreve, duke përfshirë edhe ato bujqësore,**
- Identifikimin e bizneseve të reja.**

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

- Respektimi i orarit të punës, diciplinë në pastërti dhe estetikë mbrenda dhe jashtë objekteve të QPS, QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve dhe Shtëpinë e Komunitetit,**
- Funksionalizimi i recepcionit, dhomës së triazhit dhe riorganizimi i ordinancave dhe shërbimeve në QKMF,**
- Funksionalizimi këshillimorës nëQKMF dhe mbajtja e komunikimit të rregullët me qytetarët,**
- Funksionalizimi i shërbimit të Patronazhit,**
- Furnizimi i rregullt me barna esenciale të të gjitha QMF-ve dhe AMF-ve dhe furnizimi me prioritet me barna në shërbimin e Emergjencës,**
- Vazhdimi i vizitave në shtëpi për nënen dhe fëmijen deri në 3 vjet (vizita të karakterit këshillues),**
- Vizita sistematike të integruara (shërbime mjekësore dhe sociale) nëpër shkolla, çerdhe të fëmijeve dhe mbajtja e ditëve botërore të shëndetësisë,**
- Hartimi i strategjisë (Master Planit) për shëndetësinë në Lipjan,**
- Digjitalizimi i QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve. Shenjëzimin e hapësirave mbrenda me shenja orientuese për pacientët,**
- Investim në blerjen e një Autoambulance për shërbimin e Emergjencës. Si dhe blerja e një Autokombi për bartjen e pacientëve me hemodializë në QKUK,**
- Furnizimi i QKMF-së, shërbimit të emergjencës dhe Martenitetit, QMF-ve dhe AMF-ve me aparaturë mjekësore,**
- Renovimi i objektit të Maternitetit.**

Drejtora ti për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

- Ngritja e kapaciteteve me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe efektive sipas kërkesave të qytetarëve dhe në harmoni me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit,**
- Hartimi i dokumenteve planore dhe dokumentacionit tekniko projektues për projektet e planifikuara për vitin 2019,**
- Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimore dhe leje tjera urbanistike sipas ligjeve dhe planeve në fuqi,**
- Zbatimi i planit zhvillimor urban,**
- Ndërtimi dhe aprovimi i Hartave zonale në zonat urbane dhe jo urbane.**
- Ngritja e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies në cilësinë e shërbimeve,**
- Senzibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit,**

Drejtora ti për Gjeodezi dhe Kadastrë

- Vazhdimi i digjitalizimit të shërbimeve të gjeodezisë dhe lidhja e drejtpërdrejtë me sistemin e të dhënave me Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK), përkatësishtë bartja e të dhënave grafike nga Zyra Komunale Kadastrale (ZKK) në Lipjan dhe lidhja e drejtpërdrejtë me AKK në Prishtinë,**
- Vazhdimi i azhurimit në softverin e avancuar për azhurnimin e të dhënave grafike “CAD MAP”,**
- Pjesëmarrja në vazhdimësi në trajnime, aftësime profesionale dhe avancime tjera,**
- Ngritja profesionale dhe rritja e të hyrave në Drejtorat,**
- Synojmë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës që në suazë të projekteve që ka për rindërtimin e zonave Kadastrale ta ketë konsideratë Komunën tonë që ta fus në projekt ndonjë zonë Kadastrale në Rindërtim.**

Drejtoria i Shërbimeve Publike

- Mbikqyrja e punimeve të kompanive të kontraktuara,**
- Inicimi i procedurave për realizimin e projekteve kapitale të planifikuara,**
- Mbikqyrja dhe menaxhimi gjatë realizimit të projekteve për investimet kapitale,**
- Bashkëpunimi me ndërmarrjet e shërbimeve publike,**
- Kujdesi për furnizim të rregullët me ujë të pijes, dhe rrjete funksionale të kanalizimeve,**
- Mirëmbajtja e shtretërve të lumenjëve,**
- Mirëmbajtja e ndriqimit publik,**
- Mbikqyrja dhe organizimi i transportit publik të udhëtarëve,**
- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore,**
- Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve komunale.**
- Investimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët komunale,**
- Mirëmbajtja e parqeve, krastitja e drunjëve dekorues dhe mbjellëja e luleve në hapsirat e caktuara.**

Drejtoria e Prokurimit

Objektivat e Drejtorisë së Prokurimit gjatë vitit 2019 janë:

- Realizimi i aktiviteteve të prokurimit të parapara sipas Planifikimit të Prokurimit për vitin Fiskal 2019,**
- Implementimi i agjendës buxhetore sipas Buxhetit Komunal.**
- Zhvillimi procedurave transparente dhe standarde sipas E-Prokurimit,**
- Publikimi i të gjitha procedurave të prokurimit.**
- Publikimi i të gjitha kontratave në (websajtë),**
- Funksionalizimi i databazës për blerje të imëta,**

Drejtoreti për Bujqësi dhe Pylltari

-Vazhdimi i stimulimit të zhvillimit të bujqësisë dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese - përpunuese.

-Përgaditja, prezentimi, kërkesa dhe zbatimi i projekteve të ndryshme.

-Ngritja profesionale dhe mirëqenja ekonomike e fermerëve përmes subvencioneve dhe shërbimeve këshillimore.

-Bashkëpunimi me Agjensionin e Pyjeve të Kosovës për pyllzim, ripyllzim, rrallim, ruajtjen e florës dhe faunës.

-Modernizimi i bujqësisë përmes tërheqjes së investitorëve.

-Hulumtimi i donacioneve me qëllim realizimin e projekteve të ndryshme në lëmin e bujqësisë.

-Bashkëpunimi i ngushtë me MBPZHR, lidhur me implementimin e subvencioneve që ipen për fermerët e komunës tonë.

-Zbatimi i projekteve për këshilldhënje në bashkëpunim me shërbimet këshillimore të MBPZHR-së dhe Fakultetit të Bujqësisë.

-Stimulimi i mundshëm i fermerëve që do të merren me kultivimin e bimëve mjeksore dhe aromatike.

-Mbajtja e një panairi me karakter promovues të prodhimeve bujqësore.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

- Studimi, implementimi i strategjisë dhe planit të veprimit dhe strategjive tjera të sigurisë të nxjerrura nga QRK, MPB.**
- Hartimi i planit vjetorë të KKSBB për vitin 2019, hartimi i planit të trajnimeve të zjarrfikësve.**
- Kompletimi i të dhënave zyrtare prej drejtorive komunale dhe shënimeve nga tereni për hartimin e vlerësimit të rrezikut për Komunën e Lipjanit,**
- Krijimi i një data baze të të dhënave afariste nga lëmia e ndërtimit të cilët mund të angazhohen në tejkalimin e ndonjë emergjence madhore,**
- Hartimi “Vlerësimi i rrezikut për Komunën e Lipjanit**
- Hartimi i dokumenteve të planit për mbrojtje dhe shpëtim sipas ligjit dhe në bazë të vlerësimit,**
- Implementimi i planit të ligjeratave dhe trajnimeve që do të mbahen me nxënësit e shkollave në parandalimin e zjarreve fushore dhe malore,**
- Inicimi i themelimit dhe mirëmbajtjes së një fondi emergjentë për përdorim në rrethana emergjente dhe situata të jashtëzakonshme.**